

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zjarr i madh në Athinë, shkumbohet sërish lokali ku 3 vite më parë u vra Pëllumb Islami
ADRESA	https://tpz.al/zjarr-i-madh-ne-athine-shkumbohet-serish-lokali-ku-3-vite-me-pare-u-vra-pellumb-islami-i334078
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 15:11:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 15:09:18 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9c8899db21557c9a1550fef33befcc4347171fb30b7e7ce9c3b55869d3a2434d
TEKSTI	fb41ce82c03e8b96f0db952c020f6aa29a30a793e6264547a03a0066c71884d4
PAMJA	d1f04647a8f1eda19b75926dbb38be14350ce2e43d9a26c4672388ee22dcdd5e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0d5b28d8be18dd18242b79255a73d5a76235c275cd9c13cec0053eef0809bcc7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	70759019bbdb922600e92acf251987d45dad965704b935fe53775a49569cfd8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0d5b28d8be18dd18242b79255a73d5a76235c275cd9c13cec0053eef0809bcc7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET, 28 SEPTEMBER 2026, 17:09

Zjarr i madh në Athinë, shkrumbohet sërish lokali ku 3 vite më parë u vra Pëllumb Islami

tpz.al TPZ



Një lokal në Nea Ionia të Athinës është përfshirë nga flakët në orët e para të mëngjesit, ndërsa zjarri është përhapur me shpejtësi edhe në tre katet e ndërtesës mbi të.

Ngjarja ka ndodhur në një kafene në rrugën Kastamonis, e cila është shkrumbuar nga zjarri. Flakët kanë shkaktuar dëme të mëdha edhe në apartamentet dhe ballkonet e kateve të sipërme të ndërtesës.

Sipas raportimeve të para, banorët kanë dëgjuar zhurma të forta dhe shpërthime pak para se të përhapeshin flakët. Disa dëshmitarë kanë raportuar se kanë dëgjuar disa shpërthime, ndërsa më pas kanë parë zjarrin duke u përhapur me shpejtësi.

Për shkak të tymit të dendur dhe flakëve, banorët e ndërtesës janë evakuuar. Disa prej tyre kanë dalë vetë nga objekti, ndërsa të tjerë janë detyruar të kërkojnë strehim në çati, prej nga janë nxjerrë nga zjarrfikësit. Gjashtë persona janë evakuuar nga ndërtesa.

Në operacionin për shuarjen e zjarrit kanë marrë pjesë forca të shumta zjarrfikëse, ndërsa flakët janë vënë nën kontroll pas ndërhyrjes së ekipeve në terren. Dëmet materiale në ndërtesë janë të konsiderueshme, ndërsa një dhomë gjumi në katin e dytë është përfshirë gjithashtu nga flakët.

Hetimi, dyshime për zjarrvënien të qëllimshme

Fillimisht, autoritetet kanë hetuar mundësinë që zjarri të jetë shkaktuar nga një bombol gazi apo ndonjë defekt tjetër. Megjithatë, dëshmitë për shpërthimet e dëgjua para se të niste zjarri kanë ngritur edhe dyshimet për një zjarrvënie të qëllimshme.

Hetimi tashmë po shqyrton të gjitha skenarët e mundshëm për mënyrën se si nisi zjarri. Në vendngjarje janë mbledhur prova që do t'i nënshtrohen ekzaminimeve, ndërsa autoritetet po marrin në pyetje edhe persona që mund të kenë dijeni për rrethanat e ngjarjes.

ide!

Ish-shefja e SHISH, nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiqtë e saj

Nga Lorenc Vangjeli

Rikthimi i SHISH-it në politikë si banalitë

Nga Mero Baze

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori? Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

Shiko të tiera video

Hetimi është përqendruar edhe te rrethanat që lidhen me pronarin e lokalit, ndërsa autoritetet po përpiqen të përcaktojnë nëse zjarri ishte aksidental apo rezultat i një veprimi të qëllimshëm.

Deri në këtë fazë, nuk ka një konfirmim përfundimtar për shkakun e zjarrit.

I njëjti lokal ku u vra Pëllumb Islami

Ajo që e bën edhe më të veçantë ngjarjen është fakti se bëhet fjalë për të njëjtin objekt ku në shkurt të vitit 2023 u shënua një sulm i përgjakshëm me armë zjarri, ku mbeti i vrarë shqiptari Pëllumb Islami.

Sipas versionit të policisë për ngjarjen e vitit 2023, Islami, me profesion hidraulik, ndodhej në lokal duke parë një ndeshje futbollit kur nisi përplasja me armë zjarri.

Nga kamerat filmike të sigurisë rezultoi se ditën e ngjarjes Pëllumb Islami shoqërohej nga një person i armatosur. Sipas hetimeve, Islami nuk ishte objektivi i sulmit. Objektivi ishte shoku i tij, i cili ndodhej në të njëjtën tavolinë dhe që dyshohet se kishte nisur sherrin me shqiptarë të tjerë.

Shoqëruesi i viktimës kishte një armë me vete dhe hyri i pari në lokal. Më pas, në ambient mbërritën edhe gjashtë persona të tjerë dhe mes tyre shpërtheu një konflikt.

Gjatë përplasjes u përdorën një revolver dhe një pistoletë. Një prej personave qëlloi drejt shoqëruesit të Islamit, i cili ishte objektivi i sulmit, por plumbi goditi Pëllumb Islamin.

Shqiptari mbeti i plagosur rëndë dhe humbi jetën si pasojë e të shtënave.

Në lidhje me vrasjen, policia greke lëshoi shtatë urdhërarreste, prej të cilave dy u ekzekutuan.

A ka lidhje zjarri me ngjarjen e vitit 2023?

Për momentin, autoritetet nuk kanë konfirmuar ndonjë lidhje mes zjarrit të fundit dhe vrasjes së Pëllumb Islamit.

Megjithatë, fakti që zjarri ka përfshirë pikërisht të njëjtin lokal ku ndodhi atentati i vitit 2023, së bashku me dyshimet për një zjarrvënie të mundshme dhe dëshmitë për shpërthime para flakëve, e kanë bërë objektin pjesë të vëmendjes së hetuesve.

Autoritetet po hetojnë nëse kemi të bëjmë me një incident aksidental apo me një veprim të qëllimshëm, ndërsa pritet që ekspertiza në vendngjarje të ndihmojë në përcaktimin e shkakut të saktë të zjarrit.

Hetimet vijojnë.

AKTUALITET / 28 September 2026, 17:00

Dyshohet se përdhunoi një grua dhe i vodhi paratë, Policia e Vlorës shpall në kërkim 43-vjeçar

AKTUALITET / 28 September 2026, 16:51

Skandali në SHISH/ Bamir Topi: Rama të mbajë përgjegjësi politike

AKTUALITET / 28 September 2026, 16:20

Salianji: Rama dhe Berisha u takuan në Rinas, u kërcënuan punonjësit e Gardës që më sollën informacion

AKTUALITET / 28 September 2026, 15:52

Ekosistemi shqiptar i inovacionit prezantohet në Bits & Pretzels: 17 startupe, nga Shqipëria, Kosova dhe diaspora

Artikull Promocional

AKTUALITET / 28 September 2026, 15:41

"Berisha, patericë e Ramës!" / Salianji: PD duhet të ngrejë në këmbë Shqipërinë, këta ikin për turizëm në Strasburg!

AKTUALITET / 28 September 2026, 15:12

"Mund të rrëzojmë çdo qeveri që duam" / Opozita i kërkon Mitsotakisit sqarime për deklaratat e supozuara të ambasadores amerikane në Athinë

AKTUALITET / 28 September 2026, 14:32

Shpallet fituesi për projektimin dhe ndërtimin e stacionit të trenit në Rinas

AKTUALITET / 28 September 2026, 14:11

"Është ngritur sistem i korruptuar!" / Tabaku: Hetimi i zyrtarëve të lartë nuk është certifikatë pastërtie për qeverinë

AKTUALITET / 28 September 2026, 13:55

Kreu i komanduar i SHISH shfaqet për herë të parë në Këshillin e Sigurisë Kombëtare, Elvis Lila me karrierë 20-viecare në

AKTUALITET / 28 September 2026, 13:37

Reagimi/ Dy të rinj tentuan të mashtrojnë Dukën duke u prezantuar si Balla, deputeti i PS: Rrjetet sociale të kontrollojnë llogaritë false

shërbimin e inteligjencës

AKTUALITET / 28 September 2026, 13:27

Detaje/ Tentuan t'i marrin 100 mijë euro Armand Dukës, iu prezantuan kreut të FSHF si Taulant Balla. Ja kush janë dy të rinjtë!

AKTUALITET / 28 September 2026, 13:15

Operacioni/ Tentoi të kalonte 16 emigrantë drejt Malit të Zi, arrestohet 39-vjeçari në Shkodër

AKTUALITET / 28 September 2026, 13:09

Bojkoti i avokatëve/ Rregullorja përçan gjyqtarët e GJKKO! Njëra palë kërkon dialog, tjetra sugjeron masa më të ashpra ndaj mbrojtësve

AKTUALITET / 28 September 2026, 12:50

Këshilli i Sigurisë Kombëtare, Presidenca: Institucionet nuk konkurrojnë me njëri-tjetrin, mosbesimi të zëvendësohet me bashkëpunim

AKTUALITET / 28 September 2026, 12:44

Bilanci/ Mbledhje te "Vila e Kuqe", Rama thërret sot drejtuesit politikë të PS, zbulohen detajet

AKTUALITET / 28 September 2026, 12:32

Mbledhja e Këshillit të Sigurisë, i pranishëm edhe kreu i SPAK: Pritet deklarata e Presidencës!

AKTUALITET / 28 September 2026, 12:25

Bardhi kërkon sqarime nga Rama: Kush mban përgjegjësi

AKTUALITET / 28 September 2026, 12:16

Reforma territoriale/ Debate te "Liqiet". Korreshi: Nuk po

nëse operacionet e SHISH janë
dekonspiruar për llogari të
krimit të organizuar?

bëjmë byrek këtu. Manja: Nuk
flasim dot për gardhe sot

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.